



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

NH. 3332 Prof

UDHËZIM

Nr. 10, datë 20.04.2022

PËR

“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS, LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE ONLINE TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR”,

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, si dhe në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 153 prot., datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.1.2020”,

UDHËZOJ:

1. Shërbimet që jepen online, nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar janë:
 - a) Oponenca për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale;
 - b) Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj;
 - c) Studime në fushën e Gjeoshkencës;
 - ç) Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë.
2. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, bëhet vetëm nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania (në vijim portali e-Albania), nga qytetarët, bizneset apo institucionet.
3. Kostot për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, janë specifike sipas dokumentit gjeologjik të kërkuar, bazuar në tarifatat e përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët me Nr. 5105/5, datë 19.08.2021 dhe 11557/3, datë 31.08.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”.

4. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimit për "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë, i cili ngarkohet nga kërkuesi në portalin e-Albania:

- a) Studimi dhe materiali grafik që kërkohet t'i bëhet oponenca sipas rastit;
- b) Harta dhe material tjetër grafik shoqërues i studimit.

5. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", ndiqet procedura si më poshtë:

- a) Kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin e-Albania;
- b) Pas zgjedhjes së shërbimit "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;
- c) Pas plotësimit të kërkesës së përbashkët nga kërkuesi dhe dhënësi me të dhënat e nevojshme, bëhet konfirmimi i pagesës;
- ç) Kërkuesi brenda 15 ditëve, njoftohet tek seksioni "Dokumentet e mia" në portalin e-Albania për shërbimin e kërkuar.

6. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj", nuk nevojitet dokumentacion shoqëruës.

7. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj", ndiqet procedura si më poshtë:

- a) Kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin e-Albania;
- b) Pas zgjedhjes së shërbimit "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;
- c) Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.
- ç) Kërkuesi brenda 5-10 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin e-Albania, për studimet pa llogaritje rezervash.
- d) Kërkuesi brenda 20-30 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin e-Albania, për studimet me llogaritje rezervash.

8. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Studime në fushën e Gjeoshkencës", nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

9. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Studime në fushën e Gjeoshkencës", ndiqet procedura si më poshtë:

- a) Kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin e-Albania;

b) Pas zgjedhjes së shërbimit "Studime në fushën e Gjeoshkencës", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.

ç) Kërkuesi brenda 30-90 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin e-Albania, për shërbimin e kërkuar.

10. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

11. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit e-Albania për "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", ndiqet procedura si më poshtë:

a) Kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin e-Albania;

b) Pas zgjedhjes së shërbimit "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.

ç) Kërkuesi brenda 5-10 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin e-Albania, për shërbimin e kërkuar.

12. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Belinda Balluku
